



Ligji 161/2020 date 23.12.2020

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT,
NR. 33, DATË 11.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 7703, DATË 11.5.1993,
‘PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:**

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.33, datë 11.12.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, ‘Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar.

Miratuar në datën 23.12.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11899, datë 5.1.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

Botuar ne F.Zyrtare 3/2021

Dale nga shtypi me 08.01.2021

AKT NORMATIV

Nr. 33, datë 11.12.2020

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 7703, DATË 11.5.1993,
“PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pas nenit 5/1/a, të ligjit nr. 7703, date 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shtohet neni 5/1/b, me këtë përmbajtje:

“Neni 5/1/b

Trajtim i veçantë familjar

Familja, e cila ka humbur aksidentalisht pjesëtarë të saj, si pasojë e veprimeve të kryera gjatë ushtrimit të detyrës nga punonjës të organeve ligjzbatuese, përfiton trajtim të veçantë financiar deri në masën e tetëfishit të pensionit social. Trajtimi i veçantë financiar dhe anëtari që përfiton në emër të familjes, përcaktohet me vendim individual të Këshillit të Ministrave dhe financohet nga buxheti i shtetit.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Botuar ne F.Zyrtare 217/2020

Dale nga shtypi me 14.12.2020